



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2022:098699

Datë: 01.09.2022

Numri i dokumentit: 03381595

**P.nr.198/22**

**NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË-Departamenti i Përgjithshëm**, Gjyqtarja **Ilirjana Hoti**, me sekretaren juridike Flutur Nagavci, në çështjen penale kundër të akuzuarve A. I. nga fshati . . . Komuna Gjakovë dhe të akuzuarit F. K. nga fshati . . . Komuna Gjakovë , për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 185 par.1 nën.par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, si dhe të akuzuarit I. C. nga Turqia për shkak të veprës penale të sulmit nga neni 184 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjakovë, PP/II nr.1457/21 të datës 16.05.2022, në shqyrtimin fillestar të mbajtur më datë **17.08.2022**, në prani të Prokurorit të shtetit Qazim Xharra , si dhe të akuzuarve A. I. B dhe F. K., me datën 19.08.2022, mori dhe publikisht shpalli , ndërsa përpiluar me datën 30.08.2022 këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari **A. I.** , nga fsh. . . K Gjakovë, Rr ”. . . , data e lindjes . . . , në Gjakovë, i biri i S. dhe i nënës Gj. e gjinisë Z., ka te kryer shkollën e mesme , punëtor , i gjendjes se dobët ekonomike , shqiptar , shtetas R. Kosovës, i martuar , atë i tre fëmijëve, me ID . . .

I akuzuari **F. K.** , nga fsh. . . K Gjakovë, Rr ”. . . “p.n., data e lindjes . . . , në Gjakovë, i biri i R. dhe i nënës Z. e gjinisë J., ka te kryer shkollën e mesme , punëtor , i gjendjes se dobët ekonomike , shqiptar , shtetas R. Kosovës, i pamartuar, me ID . . .

**J a n ë f a j t o r**

**Sepse :**

- me datë **09.10.2021** rreth orës **22:35** minuta në Rr. . . në Gjakovë, saktësisht në objektin e kompanisë “. . .”, me dashje dhe në bashkëveprim me njëri tjetrin i shkaktojnë lëndime të lehta trupore të dëmtuarit I. S., në atë mënyrë që natën kritike pas një mosmarrëveshje që kishin mes vete lidhur me shkarkimin e materialit nga kamioni të cilin e kishte sjellur i dëmtuari, ku të njëjtit fillimisht fjalosen e më pas i pandehuri A. I. e godet me grusht në fytyrë, në ato qaste i dëmtuari e nxjerr nga kamioni një shufër metalike dhe i vërsulet të pandehurit A., mirëpo nga pas i afrohet i pandehuri F. K. i cili gjithashtu fillon ta kodet në pjesë të ndryshme të trupit me grushte dhe shqelma, me ç ‘rast të dëmtuarit i shkaktojnë lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, të përshkruara si në akt ekspertimin mjeko-ligjor të Dr. A. G. datë 23.01.2022.

- me çka kanë kryer veprën penale, lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 185 par.1 nën.par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

**Andaj Gjykata në mbështetje te nenit 4, 7, 17 par.1, 38, 39, 40, 43, 69,70 nenit 185 par 1 nën par 1.4 e lidhur me nenin 31 të KPRK-së dhe nenit 365 te KPPK-së, -së, të akuzuarve iu shqipton;**

### **DËNIM ME GJOBË**

Të akuzuarit **A. I.**, dënim me gjobë në shumën prej **250 (dyqind e pesëdhjetë ) euro**, të cilën shumë obligohet që ta paguaj në afat prej 30 ditësh, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Të akuzuarit **F. K.**, dënim me gjobë në shumën prej **250 (dyqind e pesëdhjetë ) euro**, të cilën shumë obligohet që ta paguaj në afat prej 30 ditësh, pasi që Aktgjykimi të merr formë të prerë e nën kërcënim të përmbarimit me dhunë .

Nëse dënimi me gjobë nuk mund të ekzekutohet as me detyrim dhe në forma tjera të parapara sipas nenit 43par.3 të KPRK-së ,atëherë i njëjti do t'iu zëvendësohet me dënim burgimi në kohëzgjatje prej **12(dymbëdhjetë ) ditësh** ,duke llogaritur për çdo ditë burgu prej **20,- €(njëzetë)euro**.

I dëmtuari **I. S.** , nga Turqia me vendbanim në Sahinbey –Turki , për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet ne kontest civil.

Detyrohen të akuzuarit që në emër të kompensimit të viktimave të krimit ti paguajnë shpenzimet në shumë prej nga **30,00 €**, në mënyrë solidare shpenzimet procedurale –në emër të ekspertizës mjekoligjore shumë prej **20.00 euro** si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumë prej nga **20.00 €** , në afat prej **15 ditëve** , pasi Aktgjykimi të merr formë të prerë, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë në.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Themelore në Gjakovë, me aktakuzën PP/II nr.1457/21 të datës.16.05.2022,ka akuzuar të akuzuarit **A. I.** nga fshati . . . Komuna Gjakovë dhe të akuzuarit **F. K.** nga fshati . . . Komuna Gjakovë , për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 185 par.1 nën.par.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës si dhe të akuzuarit **I. C.** nga Turqia për shkak të veprës penale të sulmit nga neni nga neni184 par.2 lidhur me par.1 të KPRK-së , duke propozuar që të njëjtit të shpallen fajtor të dënohen sipas ligjit dhe të obligohen në pagesën e shpenzimeve procedurale.

Gjykata me kërkesën e të akuzuarve **A. I.** dhe **F. K.** dhe pajtimit të prokurorit të shtetit ,me qellim të mos prolongimit të procedurës ,me që nuk ishte prezent e akuzuari **I. S.** nga Turqia me Aktvendimin P.nr. 198/22 , është veçuar procedura penale për të akuzuarin **I. S.** Nku për të njëjtin procedura penale do të vazhdojë me numër të ri të lëndës dhe për të njëjtin gjykata do të lëshojë Urdhër arrest

Gjatë shqyrtimit fillestar të mbajtur me dt. 19.08.2022 , prokurori i shtetit **Qazim Xharra** ,lexon aktakuzën ,PP/II nr.1457/21 të datës.16.05.2022,, me ç rast deklaroi se mbetet në tërësi pranë aktakuzës sa i përket të pandehurve **A. I.** dhe të akuzuarit **F. K.** .

I akuzuari **A. I.**, gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë deklaroi thekson se e pranon në tërësi fajësinë sipas aktakuzës me të cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimi të fajësisë dhe atë në mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer në afekt meqenëse, kemi qenë të provokuar nga këtu i akuzuari **I. S.**,

premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe ne te ardhmen do të jem me i kujdesshme , andaj i propozoi gjykatës që të marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, pendimin e shprehur në gjykatë për veprimet e mija, gjendjen e dobët ekonomike , meqenëse, me të ardhurat e mija mbaj familjen prej 7 anëtarëve, premtimi se ne te ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale te natyrës se njëjtë apo te ngjashme si dhe faktin se është hera e parë që kam ra ndesh me ligjit te me shqiptojë një dënim me te butë .

I akuzuari F. K., gjatë shqyrtimit fillestar duke u deklaruar lidhur me fajësinë , deklaroi se e pranon ne tërësi fajësinë sipas aktakuzës me te cilën pandehet duke i ditur edhe me pare pasojat e pranimit te fajësisë dhe atë ne mënyrë vullnetare dhe pa presion, shtojë se me pranimin e fajësisë jam penduar për veprën e kryer në afekt meqenëse, unë me kolegun A. I. kemi qenë të provokuar nga këtu i akuzuari I. S., premtojë se një veprim i tillë nuk do të përsëritet dhe ne te ardhmen do të jem me i kujdesshëm , andaj i propozoi gjykatës që të marr parasysh rrethanat lehtësuese si pranimi i fajësisë, pendimin e shprehur në gjykatë për veprimet e mija, gjendjen e dobët ekonomike , me të ardhurat e mija mbaj familjen prej 4 anëtarëve, premtimi se ne te ardhmen nuk do të përsërisë vepra penale te natyrës se njëjtë apo te ngjashme si dhe faktin se është hera e parë që kam ra ndesh me ligjit te me shqiptojë një dënim me te butë .

Duke u deklaruar lidhur me fajësinë nga të akuzuarit Prokurori i shtetit Qazim Xharra ,deklaroi se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga këtu të akuzuarit A. I. dhe F. K. pasi që të njëjtit pranimin e fajësisë e kanë bere ne mënyrë vullnetare dhe pa presion duke i kuptuar pasojat dhe favorët e pranimit te fajësisë te sqaruara nga ana gjykatës ,e duke marr parasysh se aktakuza ka mbështetje ne provat personale dhe materiale ne bazë te cilave është paraqitur gjendja faktike ne dispozitivin e parë, ku edhe përmbushen te gjitha elementet e veprës penale me te cilat ngarkohen të akuzuarit.

Në shqyrtimin fillestar gjykata ka vërtetuar këtë gjendje faktike :

Në tërësi u vërtetua se të akuzuarit A. I. dhe F. K. : - **me datë 09.10.2021 rreth orës 22:35 minuta në” Rr...” në Gjakovë, saktësisht në objektin e kompanisë “. . .”, me dashje dhe në bashkëveprim me njëri tjetrin i shkaktojnë lëndime të lehta trupore të dëmtuarit I. S., në atë mënyrë që natën kritike pas një mosmarrëveshje që kishin mes vete lidhur me shkarkimin e materialit nga kamioni të cilin e kishte sjellur i dëmtuari, ku të njëjtit fillimisht fjalosen e më pas i pandehuri A. I. e godet me grusht në fytyrë, në ato qaste i dëmtuari e nxjerr nga kamioni një shufër metalike dhe i vërsulet të pandehurit A., mirëpo nga pas i afrohet i pandehuri F. K. i cili gjithashtu fillon ta kodet në pjesë të ndryshme të trupit me grushte dhe shqelma, me ç ‘rast të dëmtuarit i shkaktojnë lëndime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin, të përshkruara si në akt ekspertimin mjeko-ligjor të Dr.A. G.datë 23.01.2022..- **me çka kanë kryer veprën penale, lëndim i lehtë trupor në bashkëkryerje nga neni 185 par.1 nënpar.1.4 lidhur me nenin 31 të KPRK-së.****

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga vet pranimi i fajësisë nga të akuzuarit të cilët në shqyrtimin fillestar vullnetarisht kanë pranuar fajësinë, për shkak të së cilës gjykata nuk ka administruar provat, gjykata ka ardhur në përfundim se pranimi i fajësisë nga të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 te KPPK-ës. Gjatë pranimit të fajësisë gjyqtari i vetëm gjykues konstatojë se të i akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, pranimi është bërë vullnetarisht nga të akuzuarit, pranimi i fajësisë mbështetet në faktet dhe provat që i përmban aktakuza, në materialet e prezantuara nga prokurori i shtetit dhe çdo provë tjetër dhe se aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjykata nga të cekurat më lartë ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarve formohen te gjitha elementet e veprave penale të përshkruara si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe për këtë ka vendosur që të akuzuarit ti shpallë fajtor dhe ti gjykojë në bazë të ligjit, më parë duke vërtetuar përgjegjësisë penale juridike të tyre.

Me rastin e matjes së dënimit ,gjkata ka pasur parasysh të gjitha rrethanat nga neni 69 të KPRK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit . Rrethana rënduese nuk gjeti përpos konstatimit të kryerjes së veprës penale si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi ndërsa si rrethana lehtësuese gjykata ka marrë parasysh personalitetin e të akuzuarve se akuzuari A. I. është baba i 3 fëmijëve ndërsa i akuzuari F. K. i moshës relativisht të re , pranimin e vullnetshëm të fajësisë nga të akuzuarit , sjelljen korrekte të akuzuarve në gjykim, pendimin e tyre për veprën e kryer në afekt pasi të njëjtit edhe janë sulmuar nga i dëmtuari- i akuzuari I. C. , premtimin se në të ardhmen nuk do të kryejnë vepra penale të natyrës së njëjtë apo të ngjashme, kërkim faja nga i dëmtuari për lëndimin e shkaktuar të dëmtuarit , gjendjen e tyre të dobët ekonomike si dhe faktin se është hera e parë që kanë ra ndesh me ligjin, të cilat rrethana ndikuan që Gjykata ti zbatoi dispozitat e zbutjes së dënimit të parapara me nenin 70 të KPRK-së. Kështu që duke mos gjetur rrethana posaçërisht rënduese gjykata ka ardhur në përfundim se me dënim me gjobë në shumën prej nga **250 (dyqind e pesëdhjetë) euro** , do të arrihet efekti dhe qëllimi i tij nga neni 38 të KPRK-së dhe ky dënim i tillë i shqiptuar sipas bindjes së gjykatës është në proporcion me veprën penale të kryer dhe me rrethanat personale të cilat i posedojnë të akuzuarit dhe se ky sanksion do të ndikoj tek të akuzuarit që në të ardhmen të mos kryejnë j vepra penale, si dhe do të ndikoj tek të tjerët në ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Gjykata, duke u bazuar në nenin 463 paragrafi 2 të KPP, ka vendosur që të dëmtuarin I. C., , për realizimin e kërkesës pasurore juridike ti udhëzojë në kontest të rregullt juridiko civil, ngase, të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, të kërkesës pasurore juridike .

Vendimi mbi shpenzimet procedurës penale dhe atë në emër të ekspertizës mjeko –ligjore 20.00 € dhe paushallit gjyqësor në shumë prej nga 30,00 €, është bazuar në dispozitat e nenit 450 par.1dhe 2 nën paragrafi 2.1 dhe 2.6 te KPPK-së, dhe shpenzimet në shumë prej 30.00 € është marr konform nenit 39 par.3 nën.par.3.1 të Ligjit Nr. 05/L-036. për kompensimin e Viktimave të Krimit .

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJAKOVË,  
P.nr.198/22 më datë 30.08.2022**

**Sekretarja juridike,  
Flutur Nagavci**

**Gj y q t a r j a,  
Ilirjana Hoti**

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktgjykimi mund te paraqitet ankesë, në afatin prej **15 ditësh**, nga dita e marrjes së tij ne dorëzim ,Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa në kopje të mjaftueshme i dorëzohet kësaj Gjykate.